

## Syllabusi i lëndës: Menaxhimi i klasës

Të dhënat bazike për lëndën	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë
<b>Titulli i lëndës:</b>	Menaxhimi i klasës
<b>Niveli:</b>	MA
<b>Statusi i lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	I (semestri I)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+1
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5
<b>Koha / lokacioni:</b>	Për t'u definuar
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. dr. Islam Krasniqi
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Islam.krasniqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Kjo lëndë synon përgatitjen e studentëve për mjedisin e klasës, duke u dhënë atyre informacione dhe duke ofruar shkathtësi lidhur me ndërtimin e procedurave rutinore në klasë, vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve pozitive me nxënësit, sigurimi i informacionit kthyes pozitiv për ta, motivimin e sjelljes së dëshiruar të nxënësve dhe shfrytëzimin e literaturës relevante për menaxhimin e klasës. Gjithashtu, lënda është dizajnuar të përfshijë edhe analizën e shkaqeve për sjelljen problematike dhe jocompliante të nxënësve, si dhe forcimin e kompetencave menaxhuese të këtyre çështjeve nga ana e mësimdhënësit.
Qëllimet e lëndës:	
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njohë studentët me rregulloret përkatëse për menaxhimin e klasës;</li> <li>- Të njohë studentët me modele të ndryshme të menaxhimit të problemeve në klasë;</li> <li>- Të bëjë lidhjen midis rregulloreve të menaxhimit të klasës dhe sjelljes së studentëve në klasë;</li> <li>- Të njohë studentët me strategji menaxhimi për popullata të caktuara në klasë;</li> <li>- Të nxisë demonstrimin nga ana e studentëve të shkathtësive për ruajtjen e një mjedisi të sigurtë, efikas dhe mbështetës në klasë.</li> <li>-</li> </ul>
Rezultatet e pritura të nxënies:	
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Në fund të lëndës studentët do të kenë fituar aftësi të menaxhimit të klasës, do të jenë në gjendje të aplikojnë strategji dhe modele të ndryshme të menaxhimit efikas të klasës, si dhe do të jenë në gjendje t'i adaptojnë ato për klasë me popullatat specifike.

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultime	2	2	4
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	4	4	16
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezentimet, etj	3		3
<b>Total</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime individuale dhe grupore, studime rasti dhe diskutime në klasë.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 5% Përkushtimi vetanak ne shtëpi / detyrat 5% Punimi seminarik: 30% Provimi final: 60%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Evertson, C., & Weinstein, C. (2006). <i>Handbook of Classroom Management: Research, Practice and Contemporary issues</i> . Laurence Erlbaum Associates, Inc., Publishers. ISBN: 0-8058-4753-7.		
<b>Literatura shtesë:</b>			

<b>Plani i detajuar edukativ për një semester</b>	
<b>Java</b>	<b>Tema</b>
<b>Java 1</b>	Prezantimi i planit mësimor dhe diskutim
<b>Java 2</b>	Hyrje: Menaxhimi i klasës si fushë e kërkimit dhe historia e saj e hulumtimit
<b>Java 3</b>	Paradigma alternative të studimit
<b>Java 4</b>	Menaxhimi i klasës dhe diskursi klasor
<b>Java 5</b>	Perspektiva e teorisë kritike mbi klasën sociale, racën, gjininë, dhe klasën
<b>Java 6</b>	Perspektivat e studentit dhe mësimit në menaxhimin e klasës
<b>Java 7</b>	Menaxhimi i klasës për zhvillim moral dhe social
<b>Java 8</b>	Programet për menaxhim të klasës dhe disiplinat
<b>Java 9</b>	Mësimdhënja dhe mësimnxënja në klasë
<b>Java 10</b>	Perspektivat e reja dhe ato në zhvillim e sipër
<b>Java 11</b>	Menaxhimi i klasës në kontekste specifike
<b>Java 12</b>	Menaxhimi i formateve udhëzuese
<b>Java 13</b>	Teoria e hulumtimit dhe implikimet
<b>Java 14</b>	Politikat, ligji, etika dhe ekuiteti
<b>Java 15</b>	Perspektivat ndërkombëtare mbi klasën
<b>Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimitdhënësi do të ndihmojë të nxënësit e studentëve dhe arrijtjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm;</li> <li>- Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore;</li> <li>- Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;</li> <li>- Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimitdhënësit;</li> <li>- Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;</li> </ul>	